



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:193238

Datë: 13.02.2024

Numri i dokumentit: 05323414

C.nr.33/24

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klimë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: A. B. nga fshati G... , Komuna Klinë, i përfaqësuar nga i autorizuari Rr. B. , avokat në K... , kundër të paditurës: Komuna e Klinës e përfaqësuar nga avokati publik komunal, A. Sh. , me objekt kontesti, pagese e diferencës së të ardhurave personale sipas koeficientit, jashtë seance më datë 13.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klimë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, shpallet **JOKOMPETENT NË PIKËPAMJE LËNDORE** për të vendosur sipas padisë së paditësit: A. B. nga fshati G... , Komuna Klinë, kundër të paditurës: Komuna e Klinës, lidhur me pagese e diferencës së të ardhurave personale sipas koeficientit.

II. Pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë, lënda i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative të kësaj gjykate, si Departament me kompetencë lëndore për të vendosur ne këtë çështje juridike.

A r s y e t i m

Paditësi A. B. , ka ushtruar padi me datë 17.09.2018 për kompensim të pagesës mujore sipas koeficientit 5, kundër të paditurës Komuna e Klinës.

Sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.5759/2022 i dt.16.11.2023, është prishur Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Pejë,Dega në Klinë

C.nr.385/2018 i dt.22.06.2022, dhe lënda i është kthyer të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Gjykata e Apelit ka udhëzuar Gjykatën e shkallës së parë që fillimisht të shqyrtoj kompetencën lëndore në këtë çështje.

Pas shqyrtimit të lëndës në riprocedurë, gjykata pas vlerësimit të padisë dhe kërkesës së saj, provave shkresore, duke pasur parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit si dhe duke u kujdesur zyrtarisht sa i përket kompetencës lëndore, gjeti se kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me këtë çështje, për shkak të ekzistimit të kompetencës lëndore të Departamentit Administrativ në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë,.

Sipas nenit 19 të LPK-së, përcaktohet se: *“Secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdesët për kompetencën e vet lëndore”*.

Gjykata, nga vlerësimi i shkresave të lëndës, gjen se Paditësi A. B. ka statusin e shërbyesit civil, fakt i cili vërtetohet edhe nga Akt Emërimi nr.142-2940/11, i dt.01.08.2011, sipas të cilit paditësi caktohet në vendin e punës: Portir në Komunën e Klinës, ku ndër të tjera në këtë Akt Emrin theksohet se i emëruari i nënshtrohet Ligjit për Shërbyesit Civil.

Meqenëse kërkesa e paditësit ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve për ngritje të koeficientit sipas vendimeve të lëshuara nga organi administrativ, dhe duke qenë se paditësi ka statusin e shërbyesit civil, dhe është i punësuar në administratën Komunale, rezulton se marrëdhënia e tij e punës i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil dhe akteve tjera përkatëse nënligjore.

Me dispozitën e nenit 1 të Neni të ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (nr. 03/l-149) parashihet se: *“ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale”*, ndërkaq me nenin 81 par.1 dhe 2 të këtij Ligji, përcaktohet se: *“Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit, dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nënpunës civil. Procedura për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe.”* Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave dhe Këshilli i pavarur mbikëqyrës”

Me nenin 3 par.6 të Rregullores nr.02/2018 për procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcaktohet se: “para parashtrimit të ankesës në Këshill, ankuesi duhet ti shtjerr procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit”. Ndërsa me nenin 8 par.2 i Rregullores nr.05/2011 për procedurat e zgjedhjes së Kontesteve dhe ankesave përcaktohet:” Ankesa duhet të dorëzohet brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”.

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave të lartcekura dhe gjendjes faktike të konstatuar, rrjedh se kompetenca lëndore për të gjykuar këtë çështje juridike i takon Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

Andaj, gjykata gjeti se për çështjen në fjalë, duhet të shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore dhe se kjo lëndë t’i dërgohet Departamentit Administrativ të po kësaj gjykate, si Departament me kompetencë lëndore që është, për të vendosur për këtë çështje juridike.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të nenit 17, 19 lidhur me nenin 392 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.33/24, datë 13.02.2024

Gjyqtarja,
Fllanza Hashani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin 15 ditë, nga pranimi i aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.